

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Në kulmin e krizës, pritët të shtohet taksë e re për naftën 3 lekë/litër – Efekti përlogaritet në 40 mln euro/vit                                                                                                                       |
| ADRESA  | <a href="https://piranjat.al/aktualitet/ne-kulmin-e-krizes-pritet-te-shtohet-takse-e-re-per-naften-3-leke-lit-i105973">https://piranjat.al/aktualitet/ne-kulmin-e-krizes-pritet-te-shtohet-takse-e-re-per-naften-3-leke-lit-i105973</a> |
| BURIMI  | piranjat.al                                                                                                                                                                                                                             |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 25 shtator 2026, 07:49:22 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 07:42:36 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | be0cb7bbd52f65c3efe6192241e17af3afaf16781285f5488377682f393a48ab |
| TEKSTI     | 17fdaaf234de749057d0aaa8fc77a5965430e91b382c5c85b0585638d1f74653 |
| PAMJA      | 8465a6728bee1a1f5098b33e7de41c4e757fe2c89199c5975e9f62d784248d53 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | efb3213f26074f53c09e0695d24cebfe91eb3a2ecbd4c23a45ed518082f95ca5                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 03bdce4b1a721a6f1a89a4ef485ddb946ec31f15b1790ea3cb05a93e1803ce0e                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/efb3213f26074f53c09e0695d24cebfe91eb3a2ecbd4c23a45ed518082f95ca5>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

[të njëanshme](#)

strategjike me Izraelin

[turpsme ne mes të kafenesë](#)

titullit, sipas pamjeve t&eum...

[plani i diskutuar: Berlini](#)

Ballkanit Perëndimor një plan

[mbrojtje të Ergys](#)

një kompleks vilash të

[ministri i Brendshëm: Përgjegjësit](#)

përshirë ish drejtuesen e

AKTUALITET

## Në kulmin e krizës, pritet të shtohet taksë e re për naftën 3 lekë/litër – Efekti përllongaritet në 40 mln euro/vit

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 09:42



Në kulmin e krizës së çmimeve, karburanteve pritet t'u shtohen edhe 40 mln euro të tjera në vit barra fiskale nga vendosja e një tarife të re. Qeveria supozon që niveli i saj të jetë 3 lekë për litër.

Të ardhurat nga tarifa e re për naftën do të përdoren për të financuar krijimin dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë me naftë bruto dhe nënprodukte të saj.

Por rritja e barrës fiskale te karburantet do të shtrenjtojë më tej çmimin final të shitjes për konsumatorin. Efektet në rritjen e çmimit final të shitjes për konsumatorin, pranoen edhe nga qeveria.

Në relacionin e projektligjit "Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", qeveria supozon se nëse niveli i tarifës për rezervën e sigurisë së naftës do të jetë 3 lekë për litër, prej saj do të arkojë 3,75 mld lekë të ardhura në vit.

Të ardhurat do të përdoren për blerjen e naftës rezervë, për të mbuluar kostot e depozitimit etj.

Megjithatë në relacionin e draftit sqarohet se niveli prej 3 lekë për litër për tarifën është i supozuar, pasi niveli përfundimtar do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas propozimeve të ministrave përgjegjëse.

Por rezerva parashikohet të krijohet për një periudhë 5 -vjeçare, duke e çuar efektin financiar të arkëtimit nga tarifa në vlerën e rreth 200 mln eurove.

"Me qëllim financimin e krijimit, mbajtjes dhe menaxhimin të rezervave të sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj, është parashikuar dhe vendosja e një tarife për këtë qëllim.

Tarifat e krijimit dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë, që aplikohen mbi sasitë e produkteve energjetike hidrokarbure, që i nënshtrohet detyrimit për pagimin e taksës së akcizës, në përputhje me ligjin nr.61/2012, datë 24.5.2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, çdo vit.

Të gjitha këto aktivitete do të shoqërohen me kosto shtesë për sektorin publik për mbulimin e shpenzimeve për krijimin, ruajtjen, mirëmbajtjen, inspektimin e rezervave të sigurisë, si dhe për aktivitetet e tjera të rregullta të autoritetit.

Sigurimi i fondeve do të kërkojë. ndër të tjera. vendosien e tarifës që do të anlikohet mbi sasitë e produkteve energjetike hidrokarbure. Kjo do të siellë rritje të vlerës në zinxhirin e markesës

financiare dhe rezultatin final të çmimit të shitjes të konsumatori”, përcaktohet në relacion.

Vendosja e një tjetër tarife të nafta, pritet të rrisë çmimin final të shitjes me pakicë edhe me 3 lekë për litër të tjera. Aktualisht nafta në vend është e ngarkuar më disa taksa dhe tarifa, përfshirë TVSH, akcizë, taksën e qarkullimit, taksë karboni, tarifën e skanimit, taksat bashkiake, tarifën e rilicensimit.

Në çmimin final të naftës barra e taksave zë 53% të atij apo në vlerë llogaritet të jetë 90 deri 100 lekë të çmimit final. Krahasuar me shtetet e rajonit, vendi ynë ka barrën më të lartë fiskale për naftën. Në shtetet si Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Kosovë mbi çmimin e shumicës së naftës llogaritet vetëm akciza dhe TVSH-ja.

Nëse produktet e karburanteve do të lehtësoheshin nga barra fiskale konsumatori vendas do të paguante në të njëjtat vlera që paguajnë vendet e rajonit.

#### **Çmimet e larta të naftës, shqiptarët paguajnë taksa për një litër dyfishin e rajonit, por ata i ulin**

##### **Kostot e krijimit të rezervës arrijnë deri 42 mln euro në vit**

Volumi i rezervës së sigurisë, sipas të dhënave orientuese llogaritet në vlerat e 43,6 deri 49 mijë ton në vit, përfshirë me naftën bruto dhe nënproduktet e saj (naftë, benzinë, karburant për avion dhe gaz i lëngshëm).

Një nga skenarët e llogaritur nga qeveria është krijimi i rezervës me një sasi prej 43,6 mijë ton karburante. Peshën kryesore do të mbajë nafta bruto, në një sasi prej 17,4 mijë to. Dieseli në sasinë e 13 mijë ton, benzina 8,720 ton. Në sasi të vogla parashikohet rezerva gazin e lëngshëm dhe karburant avioni.

Qeveria llogarit vetëm për blerjen e karburanteve në një kosto prej 39,4 mln euro në vit dhe 2,6 mln euro në vit është kostoja e depozitimit.

Rezerva e naftës do të menaxhohet nga një Autoritet Shtetëror. Kostoja e ngritjes së autoritetit llogaritet 60 mln lekë, ndërsa kostoja për funksionimin e autoritetit llogaritet 220 mln lekë në vit sipas skenarëve të paraqitur në relacion.

Shoqata e Hidrokarbureve më herët ngriti shqetësimin për mënyrën se si qeveria parashikon ta financojë modelin e ri të propozuar për krijimin e sigurisë së naftës.

Shoqata e Hidrokarbureve se tarifa për financimin e krijimit të rezervës konsiderohet një taksë e fshehtë, pasi nuk bëhet fjalë për një shërbim që shteti i ofron kompanive, por për financimin e një detyrimi publik përmes një tarife të vendosur mbi karburantet.

##### **“Taksë e fshehtë” mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria**

po ashtu projektligji i jep kompanisë shtetërore si Autoriteti për Rezervën e Sigurisë së Naftës të drejtën të blejë dhe të shesë naftë pa prokurim publik, pra pa garë. Kjo marrëdhënie është e justifikuar me natyrën specifike të funksionimit të rezervës. E drejtë e Autoritetit për të kryer blerje dhe shitje të naftës, pa prokurim publik përcaktohet në një nga pikat e nenit 10 projektligjit “Për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave minimale të sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

##### **Rezerva e naftës do të jepet me “koncesion”, shërbimet do të kontraktohen pa prokurim**

-Tarifë orientuese minimale e rezervës: 3 lekë/litër/vit, deri në krijimin e plotë të rezervës (blerje hidrokarbure +depozitim);

– Pas krijimit do të paguhet vetëm kostoja e depozitimit të rezervës. Të ardhura vjetore të Autoritetit nga tarifa: 3.4– 3.6 -3.75 miliardë lekë/vit

-Kjo shumë do të mbulojë plotësisht funksionimin e Autoritetit, mbulon sigurimin e rezervave, sikur ato të krijohen për një periudhë prej 5 vjetësh, si dhe parashikon kostot e mbajtjes së depozituar të lëndës.

-Bazuar edhe në mendimin e Ministrisë së Financave, kostoja fillestare vetëm një herë, do të aplikohet për zhvillim sistemi për arkëtimin e tarifës: 20–30 milionë lekë. Kostoja vjetore, mirëmbajtje vjetore e sistemit: 8–12 milionë lekë.

## **Artikuj te sugjeruar**

AKTUALITET 25 Shtator09:10

### **[VIDEO/ Bledi Çuçi dhe bashkëshortja përplasen me protestuesit, gjepte të turpshme në mes të kafenesë](#)**

Një situatë e paprecedentë është regjistruar mbrëmjen e kaluar në një kafene në Tiranë. Sipas pamjeve të&eum...

AKTUALITET 25 Shtator08:37

### **[Këmbimi valutor, me sa shiten e blihen sot monedhat e huaja](#)**

Në tregun e këmbimit valutor shqiptar, një dollar amerikan do të blihet sot me 80.02 lekë dhe do shitet me 81.3 lekë. Ndër...

AKTUALITET 25 Shtator08:20

### **[Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit](#)**

Mëngjesin e 22 shtatorit, forcat e Policisë së Shtetit zbarkuan për kontroll në një kompleks vilash të fortifikuara në...

AKTUALITET 25 Shtator08:02

### **[“Shërbimi ynë jo inteligjent”- Skandali i Vlora Hysenit, ish ministri i Brendshëm: Përgjegjësit aktrojnë me hipokrizi](#)**

Ish ministri i Brendshëm, Sandër Lleshi ka reaguar për skandalin që ka përfshirë ish drejtuesen e Shërbimit Informativ Shte...

AKTUALITET 25 Shtator07:59

### **[Sigurimet drejt rregullave të reja, kapital sipas rrezikut dhe mbrojtje më e fortë për konsumatorët](#)**

Kërkesat për kapital të shoqërive të sigurimit do të bazohen në profilin e rrezikut të veprimitarisë së tyre,...

AKTUALITET 25 Shtator07:45

### **[Rikthehen reshjet e shiut, parashikimi i motit për sot](#)**

Kthjellimet mbeten dominante gjatë gjithë ditës në të gjithë Shqipërinë, përjashtuar ekstremin jugor ku mëng...

AKTUALITET 25 Shtator07:35

### **[Bizneset po kërkojnë dhe po marrin më shumë kredi](#)**

Kërkesa për kredi në sektorin bankar u rrit ndjeshëm në gjysmën e parë të këtij viti, ndërsa paralelisht edhe...

AKTUALITET 25 Shtator 07:17

### **Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe ai politik**

Rezultatet e vërtetimit mbi perceptimin e rreziqeve sistematike në vend nga sektori bankar tregojnë se, gjatë gjysmës së parë të...

AKTUALITET 25 Shtator 07:04

### **Rikthimi i penaliteteve, bizneset nuk po fitojnë, apo nuk po paguajnë; Të ardhurat bien 5%**

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë zëri me ecurinë më të dobët në buxhetin e shtetit në tetë muajt e pa...

AKTUALITET 24 Shtator 23:35

### **Prova që fundosi shefin e Policisë Shkencore, dërgoi akt-ekspertimin e makinës që rrëmbeu biznesmenin!**

Një akt-ekspertimi për makinën "Land Rover Defender", i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, ka mbërit...

## **ME TE VIZITUARAT**

AKTUALITET 24 Shtator

### **EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë n...**

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

### **Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...**

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një...

AKTUALITET 24 Shtator

### **EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...**

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator 11:40

### **EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek\*uale për 50-150 euro**

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

## **video**




**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1**





**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.